



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 29

Tiranë – E enjte, 25 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|---|--|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 17.2.2016 | Për një shtesë në vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013–2020, dhe planit të veprimit për vitet 2013–2016”..... |
| | 2407 |



VENDIM

Nr. 115, datë 17.2.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 663, DATË 17.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDERSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE TË PALIGJSHME DHE TERRORIZMIT, 2013–2020, DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITET 2013–2016”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1, me titull “Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave e plani i veprimit, 2014–2017”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, në ndarjen 2 “Qëllimi strategjik”, të fushës së dytë “Mbrojtja”, të planit të veprimit të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave, pas pikës 2(c) shtohet pika 2(ç), objektivi specifik, “Plani i veprimit për riintegrimin social-ekonomik të grave dhe vajzave, viktime të trafikimit të personave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VEPRIMI

PËR RIINTEGRIMIN SOCIO-EKONOMIK TË GRAVE DHE VAJZAVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE 2015–2017

SHKURTIME

| | |
|----------|--|
| AIDA | Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve |
| AT | Antitrafikimi |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KDF | Konventa për të Drejtat e Fëmijës |
| D&E | Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| KE | Komisioni Evropian |
| BE | Bashkimi Evropian |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare për Migracionin |
| MM | Memorandum Mirëkuptimi |
| NBS | Agjencia Shtetërore për Nxhtjen e Biznesit Social |
| SHKP | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |
| OJF | Organizata jofitimprurëse |
| QKPVT | Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit |
| MKR | Mekanizmi Kombëtar i Referimit |
| ZKKAT | Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim |
| VMT | Viktimë e Mundshme Trafikimi |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| TQNJ | Trafikimi i Qenieve Njerëzore |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi i OKB-së për Fëmijët |
| UN Women | Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave |
| VT | Viktimë e Trafikimit |
| YAPS | Fondacioni Rinor i Shërbimeve Profesionale |

“Hiqet liria e vetëm një qenieje njerëzore dhe viben në rrezikë liritë e të gjithë botës”
William Lloyd Garrison

Falënderime

Ky dokument është pjesë e pandarë e Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave (2014–2017) dhe planit të saj të veprimit¹. Është përgatitur në emër të qeverisë së Shqipërisë nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim (ZKKAT) me pjesëmarrjen e strukturave antitrafikim, përfaqësuesve të ministrive të linjës, ekspertëve për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontributin e OJF-ve që punojnë me viktimat e trafikimit.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e projektit është dhënë nga “Projekti për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës kundër Grave dhe Vajzave në Shqipëri”, si pjesë e programit “Parandalimi dhe trajtimi i dhunës kundër grave dhe vajzave në Shqipëri, Meksikë dhe Timorin Lindor”, financuar

¹ Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 814, datë 26.11.2014.



nga Bashkimi Evropian (BE), në kuadër të Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe zbatuar nga Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), në partneritet me Programin e Zhvillimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Për përgatitjen e dokumentit punoi në një proces konsultimi me të gjithë aktorët, znj. Dajena Kumbaro, konsulente e IOM-së. Puna për përgatitjen e këtij plani veprimi është kryer në një proces konsultimi me të gjithë aktorët nëpërmjet pjesëmarrjes në tri tryeza të rrumbullakëta dhe intervista individuale.

Një falënderim i veçantë shkon sidomos për stafin e organizatës psikosociale “Vatra”, “Të ndryshëm dhe të barabartë”, “Tjetër vizion” dhe Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit për kontributin e tyre të çmuar dhe mbështetjen në identifikimin e përfituesve në fazën e riintegritimit për t’u intervistuar. Së fundi, por jo me më pak rëndësi, falënderime të veçanta për përfituesit për besimin e tyre dhe kontributin, ndarjen e sugjerimeve bazuar në përvojat e tyre personale, përmirësimin e shërbimeve të riintegritimit dhe në funksion të procesit të qëndrueshëm të riintegritimit të viktimave që i kanë mbijetuar trafikimit.

A. HYRJE

1. Kërkesa për përgatitjen e planit të veprimit për riintegritimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave, viktimave të trafikimit (VT) dhe viktimave të mundshme të trafikimit (VMT)² mbështetet në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave, 2014–2017 (*tani e më tutje “Strategjia Antitrafikim”*). Strategjia parashikon marrjen e masave për hartimin e një plani veprimi për riintegritimin e VT-

² Termat që do të përdoren në këtë plan veprimi pasqyrojnë ato që përdoren në Strategjinë Antitrafikim. Procedurat standarde të veprimtarisë për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit (PSV), miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 582, datë 27.7.2011 jep përkufizimin e mëposhtëm për këta terma, përkatësisht: **Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore (VT)**: Sipas shkronjës “e”, të nenit 4, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” është personi objekt trafikimi i qenieve njerëzore. **Viktima të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore (VMT)**: Është personi për të cilin agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin paraprak gjykojnë se mund të jetë trafikuar.

ve dhe VMT-ve³ dhe nënvizion që disa nga qëllimet e tij në lidhje me ndihmën për riintegritimin për personat e trafikuar varen gjerësisht nga një sërë politikash sektoriale dhe ndërsektoriale, përfshirë ato në fushën e arsimit, punësimit, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, zhvillimit dhe integritimit, gjinisë, dhunës në familje, mbrojtjen e fëmijëve dhe antidiskriminimin⁴.

a) Kuptimi i riintegritimit

2. Riintegritimi nuk është përkufizuar në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare. Zakonisht ka të bëjë me masat e marra në kuadër të masave parandaluese kundër ritrafikimit ose trafikimit ose masave në ndihmë të VT-së⁵. Për ilustrim Konventa Evropiane për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore u kërkon shteteve palë, përfshirë Shqipërisë, marrjen e masave për të ndihmuar viktimat në rekuperimin e tyre fizik, psikologjik dhe social, duke pasur parasysh nevojat e viktimës për siguri dhe mbrojtje, në bashkëpunim me OJF-të dhe organizata të tjera të përfshira në ndihmën për viktimat. Kjo ndihmë duhet të jepet bazuar në pëlqimin dhe informimin e VT-së, duke pasur parasysh nevojat specifike të personave në pozitë të pambrojtur, si edhe fëmijët dhe nuk duhet të kushtëzohet me vullnetin e viktimës për të vepruar si dëshmitar (*neni 12*). Konventa, gjithashtu, përcakton që ndihma për viktimat e TQNJ-së duhet të përfshijë akomodim të duhur dhe të sigurt.

3. Riintegritimi është një proces. Kur një grua ose një vajzë që i ka mbijetuar një përvoje trafikimi dhe ka vendosur të qëndrojë në një komunitet ose kthehet te familja e saj dhe komuniteti i saj i mëparshëm, ky proces njihet si riintegritim, ndërsa

³ Shih Strategjinë Antitrafikim, 2014–2017. *Synimi strategjik* nr. 3 është formuluar si më poshtë: “Nxitja e kthimit dhe riintegritimit dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut të riviktimizimit dhe ritrafikimit për personat e trafikuar ose që të kthehen në trafikantë”. Nën këtë synim, objektivi specifik nr. 3(b) parashikon: “Forcimi i programeve për dhënien e asistencës afatgjatë me qëllim riintegritimin dhe përfshirjen shoqërore të të rriturve dhe të miturve që janë VMT dhe VT, në përputhje me nevojat individuale dhe me PSV-të”. Masat për të realizuar këtë objektivi, përfshijnë *inter alia* hartimin e një **plani veprimi multisektorial për riintegritimin socio-ekonomik** të VT-ve dhe VMT-ve.

⁴ Shih Strategjinë Antitrafikim, 2014–2017.

⁵ Shihni, për shembull, Konventën e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Shqipëria është palë në Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar dhe protokollit të saj për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, sidomos grave dhe fëmijëve (të dyja të ratifikuara në vitin 2001).



kur jeton në një qytet të ri ose mjedis të ri atëherë ky proces përkufizohet si integrim⁶. Një përkufizim i fjalës riintegrim është si më poshtë: “riintegrim është procesi i përfshirjes dhe i rindërtimit të marrëdhënieve brenda një komuniteti në vendin e origjinës në katër nivele: fizik, socio-ekonomik, socio-politik dhe kulturor”⁷. *Riintegrimi, gjithashtu, përkufizohet si “procesi i rikuperimit dhe përfshirjes sociale dhe ekonomike pas një përvojë trafikimi. Përfshin vendosjen në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, akses në standard jetese të arsyeshëm, mirëqenie fizike dhe mendore dhe mundësi për zhvillim personal, social dhe ekonomik dhe akses në mbështetje sociale dhe emocionale. Një aspekt qendror i riintegrimit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësi drejt pavarësisë dhe vetëmjaftueshmërisë dhe për t’u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre”⁸.*

b) Paraqitje e shkurtër e kontekstit socio-ekonomik në Shqipëri

4. Procesi i riintegrimit socio-ekonomik të grave dhe vajzave varet gjerësisht nga kushtet e përgjithshme sociale, ekonomike dhe politike në vend. Pas një periudhe të gjatë të rritjes së shpejtë ekonomike, ekonomia shqiptare ka përjetuar së fundmi pasojat e krizës ekonomike globale⁹. Rritja ekonomike pësoi rënie nga një normë 3.7% në vitin 2010 në 2.5% në vitin 2011 dhe 1.6% në vitin 2012¹⁰. Në fund të vitit 2013, rritja ekonomike kaloi në shifra negative përpara rikuperimit në fillim të vitit 2014 me një rritje të PBB-së prej 1.65% në bazë vjetore gjatë tremujorit të parë të vitit 2014¹¹. Pritshmëritë e rritjes së ardhme ekonomike janë më të ulëta sesa në të shkuarën. Vlera e remitancave

neto ka qenë rreth 9% e PBB-së në vitin 2012¹². Ndikimi është i rëndësishëm në një situatë ku një 1/5 e familjeve në Shqipëri mendohet se jetojnë me të ardhura nga migracioni (remitanca). Remitancat kanë pësuar rënie në vitet e fundit, jo vetëm një përqindje të PBB-së, por edhe në vlerë absolute sepse migrantët shqiptarë jashtë vendit janë prekur nga kriza globale ekonomike dhe si pasojë shumë prej tyre kanë humbur punën dhe janë kthyer në vendlindje¹³.

5. Një tjetër faktor që ndikon në ndërhyrjet për riintegrim lidhet me punësimin informal si një fenomen shumë i përhapur në Shqipëri¹⁴. Punësimi informal është i rëndësishëm për mirëqenien e shumë familjeve, megjithatë është i lidhur ndjeshëm me të ardhura të ulëta, varfëri dhe situatë të pambrojtur.¹⁵ Gjithashtu, riintegrimi i grave dhe i vajzave që kthehen nga një përvojë trafikimi ndikohet shumë nga pabarazitë rajonale, ku rajoni qendror ka nivelin më të lartë të PBB-së për person dhe rajoni verior ka PBB-në më të ulët¹⁶.

6. Përgjithësisht, gratë në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm në dy sektorët kryesorë të ekonomisë: shërbime dhe bujqësi¹⁷. Megjithatë, shifrat tregojnë që gjatë tre muajve të fundit të vitit 2014, ka pasur një rritje me 1.5% të grave të

¹² Komisioni Evropian, DG ECFIN, Vlerësimi Ekonomik dhe Financiar, 2013 f. 12.

¹³ Shih Projektstrategjinë Kombëtare për Mbrojtje Sociale, 2015–2020, përgatitur nga MMSR-ja.

¹⁴ Shih Projektstrategjinë Kombëtare për Mbrojtje Sociale, 2015–2020, përgatitur nga MMSR-ja, sipas së cilës nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të vlerësimit, llogaritet që gjatë periudhës 1996–2012, ekonomia informale përbënte 14 dhe 38% të PBB. Boka, M. dhe Torluccio, G. (2013) “Ekonomia informale në Shqipëri”, *Revista Akademike e Studimeve Ndërdisciplinore*, 2(8): 212–221.

¹⁵ INSTAT, “Dinamika e tregut të punës, 2001–2011”, Tiranë: INSTAT, f. 45

¹⁶ INSTAT, “Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore në Shqipëri, 2012”, *Njoftim për shtyp*, 31.7.2014. Në rajonin jugor, PBB-ja për person në vitin 2012 ishte rreth 8.5% nën mesataren kombëtare. Në vitin 2012, niveli më i lartë i PBB për person në nivel prefekturë ishte në Tiranë 41% mbi mesataren kombëtare. Prefektura e dytë më e begatë ishte Fieri (13% mbi mesataren) i ndjekur nga Durrësi (4.5 % mbi mesataren). PBB për person të të gjitha prefekturave të tjera ishte nën mesataren kombëtare. Më e ulëta ishte në Dibër (33% nën mesatare), e ndjekur nga Kukësi (30.5% nën mesatare) dhe Korçë (30% nën mesatare).

¹⁷ Ekonomia e Shqipërisë dominohet nga sektori i shërbimeve, i ndjekur nga bujqësia, e cila vazhdon të jetë punëdhënësi më i madh Mari Elena Ruiz, Abril “Politika Ekonomike të Duhura për Gratë në Shqipëri: Policy Issues and options for Women’s Economic Empowerment” *A Policy Issues Paper*, UNWOMEN 2012

⁶ Shihni Surtees, R. (2006) *Re/integration programmes in SE Europe - Punim për Fondacionin King Baudouin*. Bruksel: KBF, shihni, gjithashtu, Surtees, R., *Monitoring antitrafficking re/integration programmes. Manual*, 2010, Instituti NEXUS, Uashington.

⁷ Revista Ndërkombëtare e së Drejtës së Refugjatëve, Vëllimi 12, Oxford University Press, 2001 Riintegrimi i viktimave të trafikimit duhet të dallohet nga procesi i riatdhesimit. “Riatdhesimi i referohet procesit të rimarrjes së mbrojtjes që ofron vendi i origjinës brenda dimensioneve ligjore dhe sociale që përfshin shtetësi.

⁸ Shihni Surtees, R. (2006) *Re/integration programmes in SE Europe - Punim për Fondacionin King Baudouin*. Bruksel: KBF, shihni, gjithashtu, Surtees, R., *Monitoring antitrafficking re/integration programmes. Manual*, 2010, Instituti NEXUS, Uashington.

⁹ Shihni përmbledhjen e kontekstit ekonomik në Projektstrategjinë Kombëtare për Mbrojtje Sociale, 2015–2020, përgatitur nga MMSR-ja.

¹⁰ Banka Kombëtare e Shqipërisë, Raporti i Politikës Monetare, Q2, 2014, f. 62.

¹¹ Banka Kombëtare e Shqipërisë, Raporti i Politikës Monetare, Q2, 2014, f. 7.



papuna¹⁸.

c) Qëllimi i planit të veprimit

7. Ky plan veprimi mbulon aspektin e riintegritimit socio-ekonomik të grave dhe vajzave VT dhe VMT, në fushat e: a) fuqizimit ekonomik, d.m.th. të drejta pronësie, punësim dhe formim profesional; b) strehim; c) arsimim; dhe d) kujdesit social.

8. Riintegritimi i viktimave të trafikimit është shumëdimensional. Së pari dhe ajo që është më e rëndësishme, marrja e masave për të arritur riintegritimin do të thotë përpjekje për të shpërbërë rrethin e trafikimit, shfrytëzimit dhe skllavërisë së qenieve njerëzore. Nuk është thjesht një proces drejt realizimit të të drejtave socio-ekonomike. Në fakt, është një proces i sigurimit dhe garantimit të së drejtës për mbrojtje të grave dhe vajzave nga nënshtrimi ndaj shkeljeve të shumfishta të të drejtave të tyre themelore, si e drejta për t'u çliruar nga tortura, trajnimi çnjerëzor dhe poshtërues ose ndalimi i skllavërisë, nënshtrimi dhe puna me forcë ose e detyruar¹⁹. Mbrojtja e këtyre të drejtave themelore të njeriut është përgjegjësi e shtetit; ato janë absolute dhe nuk lejojnë shmangie²⁰. Është e panevojshme të thuhet që nëse nuk trajtohen shkaqet që çuan në trafikim, ekziston rrezik i madh për ritrafikim, riviktimizim dhe shfrytëzim.

9. Riintegritimi i suksesshëm i viktimave të trafikimit varet nga një gamë e madhe faktorësh dhe situatash përfshirë profilin individual të personit, mjedisin ku ajo do të riintegrohet, mekanizmat e ndryshëm mbështetës për riintegrim, rolin e shtetit, shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore²¹. Sugjerohet që disa kritere për përcaktimin nëse një individ është riintegruar me sukses në shoqëri dhe ekonomisht janë si më poshtë: 1) strehim ose akomodim i sigurt dhe i përbalueshëm; 2) status ligjor; 3) mundësi profesionale/punësimi; 4) mundësi arsimimi dhe

trajnimi; 5) siguri; 6) mjedis i shëndetshëm social (përfshirë antidiskriminimin dhe antimarxhinlizimin); 7) mirëqenie sociale dhe marrëdhënie pozitive ndërpersonale; 8) mirëqenie /qëndrueshmëri ekonomike; 9) akses në shërbime dhe mundësi etj.²²

B. METODOLOGJIA

10. Metodologjia për hartimin e planveprimit përfshin hapat e mëposhtëm: 1) rishikimi i literaturës për mbledhjen dhe analizën e një sërë dokumentesh, që janë identifikuar dhe kërkuar nga IOM dhe që janë shtuar nga konsulentja; 2) identifikimi i aktorëve dhe i rolit të tyre në integritimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave VT/VMT; 3) intervista me autoritete, organizata të OKB-së, OJF dhe VT personalisht; 4) vlefësimi i metodologjisë dhe seancave të konsultimit për të diskutuar boshllëqet dhe ndërhyrjet; 5) analizimi i të gjithë informacionit dhe burimeve të të dhënave; dhe 6) prezantimi i planit të veprimit/rekomandimeve tek IOM.

11. Rishikimi i literaturës përfshin legjislacionin e zbatueshëm shqiptar; traktatet ndërkombëtare (Protokolli i Palermos dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit; praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në lidhje me TQNJ-në; raportet dhe udhëzimet e IOM, manualët e IOM për integritimin e VT; analizat e mëparshme të boshllëqeve për standardet dhe praktikën; strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit për të luftuar dhe për të parandaluar TQNJ-në; Raportet Periodike dhe Vlerësimet e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar; procesverbalin e takimeve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) dhe Autoritetit Përgjegjës (AP); punimet /jurisprudencën e organeve të OKB-së dhe Këshillit të Evropës kundër trafikimit; raportet e OJF-ve përfshirë publikime të institutit NEXUS.

12. Pyetësorët u përgatitën dhe intervistat u zhvilluan me aktorë të ndryshëm, sidomos zëvendësministren e Punëve të Brendshme /Koordinatorin Kombëtar të Antitrafikimit; përfaqësues të IOM-it, UN-WOMEN-it, UNDP-së, UNICEF-it, UNHCR-së, të përfshirë në TQNJ dhe dhunën kundër vajzave dhe grave;

¹⁸ Shih sondazhin e INSTAT për krahun e punës në tre muajt e fundit të vitit 2014. http://www.instat.gov.al/media/284247/atfp_tr_4_2014.pdf

¹⁹ Shih nenin 3(a) të Protokollit të Palermos, nenin 4(a) të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nenin 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

²⁰ Për më shumë informacion shih pjesën për qasjen mbështetur në të drejtat e njeriut.

²¹ Për më shumë informacion shih Surtees, R., *Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. Manual* 2010, Institutit NEXUS, Uashington, shih, gjithashtu, Manualin E IOM-it për “Ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit”.

²² Për më shumë informacion shih Surtees, R., *Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. Manual* 2010, Institutit NEXUS, Uashington, shihni, gjithashtu, Manualin E IOM-it për “Ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit”.



përfaqësues të Task Forcës Kombëtare Antitrafikim; përfaqësues të MKR-së dhe autoritetit përgjegjës dhe komiteteve rajonale antitrafikim; përfaqësues nga Agjencia Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve; vajza dhe gra VT që kanë përfituar nga programe integrimi; D&E, Vatra, Tjetër Vizion, NBS, AIDA, YAPS etj.

13. Vleftësimi i metodologjisë dhe konsultimi. Janë organizuar tre tryeza të rrumbullakëta konsultimi me aktorët për të diskutuar metodologjinë, për të identifikuar boshllëqet dhe për të diskutuar propozimet për ndërhyrje. Procesi i vlerësimit dhe i identifikimit të boshllëqeve në legjislacion, procedura dhe praktika ka qenë pjesëmarrës dhe pasqyron këndvështrimin e të gjithë aktorëve. Në përfundim të çdo tryeze të rrumbullakët, aktorët paraqitën propozime për ndërhyrje.

a) Qasje mbështetur te të drejtat e njeriut

14. Qasja e mbështetur te të drejtat e njeriut²³ është e dukshme në Strategjinë kundër TQNJ-së dhe është qasja që drejton këtë plan veprimi. TQNJ-ja përbën një shkëlqje për dinjitetin dhe liritë themelore të njeriut dhe një shkëlqje të rëndë të të drejtave të njeriut. Kjo është konfirmuar nga GJEDNJ-ja në vendimin e saj në çështjen Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë²⁴, ku Gjykata konkludoi që TQNJ-ja, sipas kuptimit të nenit 3(a) të Protokollit të Palermos dhe nenit 4(a) të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (që ndalon skllavërinë, nënshtrimin dhe punën me forcë ose të detyruar). Gjykata, më tej, konkludon që neni 4 përfshin një detyrim pozitiv për të mbrojtur viktimat ose viktimat e mundshme, si edhe detyrimin procedural për të hetuar

²³ Qasja e mbështetur te të drejtat e njeriut është një kuadër konceptual për trajtimin e fenomenit si trafikimi që bazohet në standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe që orientohet drejt promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo qasje kërkon një analizë të mënyrave sesi shkeljet e të drejtave të njeriut shfaqen gjatë gjithë ciklit të trafikimit, si edhe detyrimet e shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo synon të identifikojë dhe të trajtojë praktikatat diskriminuese dhe shpërndarjen e padrejtë të kompetencave që janë shkak i trafikimit, që nuk ndëshkojnë trafikantët dhe që i mohojnë drejtësinë viktimave. Shihni Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, OKB, *Të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimi i Qenieve Njerëzore: Dokumenti me fakte nr. 36*, në http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf

²⁴ Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë, nr. 25965/04, GJEDNJ 2010, paragraf 282.

trafikimin.

15. Të drejtat e njeriut që kanë më shumë lidhje me trafikimin²⁵ janë:

a) Ndalimi i diskriminimit për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes ose statusit;

b) E drejta për të jetuar;

c) E drejta për liri dhe siguri;

d) E drejta për të mos qenë objekt i skllavërisë, nënshtrimit, punës me forcë ose të detyruar;

e) E drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe/ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor, poshtërues, mizor;

f) E drejta për të mos qenë objekt i dhunës me bazë gjinore;

g) E drejta për lirinë e shoqërizimit;

h) E drejta për lirinë e lëvizjes;

i) E drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor;

j) E drejta për kushte të drejta dhe të favorshme të punës;

k) E drejta për standard të përshtatshëm jetese;

l) E drejta për sigurime shoqërore;

m) E drejta e fëmijëve për mbrojtje të veçantë;

b) Pikat e referimit: Kuadri strategjik, e drejta ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar

16. Plani i veprimit merr parasysh dhe plotëson strategjitë dhe planet e ndryshme të veprimit që ndikojnë në riintegrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave VT dhe VMT. Këto strategji dhe plane veprimi përfshijnë Strategjinë Antitrafikim, 2014–2017, Strategjinë për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, Strategjinë për Punësim dhe Aftësi (2014–2020); projektstrategjinë për Mbrojtjen Sociale 2015–2020; Planin e Veprimit për Sipërmarrjen e Grave (2014–2020) etj.

17. Pikat e referimit kundrejt të cilave vlerësohen boshllëqet dhe propozohen ndërhyrjet marrin parasysh, të drejtën ndërkombëtare për TQNJ-në, udhëzimet e IOM, agjencive të BE-së, raportet e GRETA-s, si edhe praktikatat, studimet dhe raportet e përgatitura nga organizatat si NEXUS²⁶.

18. Në nivel ndërkombëtar, Shqipëria është palë

²⁵ Shih Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, OKB, *Të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimi i Qenieve Njerëzore: Dokumenti me fakte nr. 36*, në http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf

²⁶ Shihni pjesën për metodologjinë.



në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar dhe Protokollit të saj për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos grave dhe fëmijëve (të dyja të ratifikuara në vitin 2001), dhe Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit. Shqipëria është, gjithashtu, palë në një sërë traktatesh të tjera ndërkombëtare në lidhje me masat kundër TQNJ-së sidomos Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokollit i saj opsional për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve, si dhe Konventa për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave etj.

19. Në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA), Shqipëria është në proces të përafritimit të legjislacionit me të drejtën e BE-së në fushën e luftës kundër TQNJ-së, sidomos me Direktivën 2011/36/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij; Direktivën e Këshillit 2004/81/EC, e 29 prillit 2004, për lejet e qëndrimit që i jepen shtetasve të vendeve të treta që janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë objekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm dhe që bashkëpunojnë me autoritetet kompetente; Direktivën e Këshillit 2004/80/EC, e 29 prillit 2004, në lidhje me dëmshpërblimin e viktimave të krimit; dhe Vendimin Kuadër 2001/220/JHA, të 15 marsit 2001, të Këshillit të Bashkimit Evropian për pozitën e viktimave në proces penal.

C. PLANI I VEPRIMIT

a) Komponentët

20. Siç është thënë më sipër ky plan veprimi është pjesë e pandarë e Strategjisë Antitrafikim dhe mbulon fushat e mëposhtme të riintegritimit socio-ekonomik të grave dhe vajzave VT dhe VMT, përkatësisht:

- a) fuqizimin ekonomik, pra, të drejtat e pronësisë; punësim; dhe formim profesional;
- b) strehim;
- c) arsimim; dhe
- d) shërbime të kujdesit social.

21. Dokumenti përfshin një pjesë narrative që shpjegon kontekstin dhe kuptimin e secilës nga fushat e mësipërme dhe një matricë që paraqet objektivat; rezultatet; masat; informacionin bazë;

treguesit për të matur progresin e ndërhyrjes ose masës; institucionet përgjegjëse dhe afatin. Matrica është e organizuar në pesë pjesë. Pjesa I përfshin një paraqitje të Masave të Përgjithshme që janë të rëndësishme për të gjitha fushat dhe trajton të gjitha aspektet e riintegritimit socio-ekonomik²⁷. Pjesa II deri në V mbulon fushat e paraqitura në paragrafin 20.

b) Riintegritimi socio-ekonomik i grave dhe i vajzave VT/VMT: konstatime të përgjithshme

22. Aktualisht, nuk ka një studim bazë, gjithëpërfshirës, cilësor dhe sasior për riintegritimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave në Shqipëri. Megjithatë, informacion lidhur me këtë mund të sigurohet nga vlerësimet vjetore të ZKKAT-së për zbatimin e Strategjisë Antitrafikim, raporti i GRETA-s, OJF-të që punojnë me VT/VMT-të, studimet e kryera nga IOM etj. Është raportuar që gjatë vitit 2014, ka pasur 108 raste të reja të grave dhe vajzave, VT ose VMT²⁸. Shumica vijnë nga zona të varfra, rurale dhe urbane, kryesisht nga Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Berati, Vlora, Korça etj.²⁹ Niveli i tyre arsimor është çështje shqetësuese, sepse një numër i madh i grave dhe i vajzave kanë përfunduar vetëm arsimin bazë (tetë deri në nëntë vite shkollë). Disa gra dhe vajza kanë më pak se katër vite arsim formal. Vetëm pak prej tyre kanë përfunduar ose janë në proces përfundimi të shkollës së mesme dhe një ose dy janë në proces të përfundimit të studimeve universitare³⁰. Gjithashtu, situata e tyre e strehimit është shumë problematike: ato ose nuk kanë një shtëpi prindërore, ose nuk konsiderojnë familjen si shtëpinë e tyre, ose nuk janë lejuar që të jetojnë atje³¹. Pothuajse të gjitha gratë dhe vajzat e trafikuar tregojnë një histori të dhunës në familje,

²⁷ Ju lutemi të vëreni që pjesa e kostos në këtë plan veprimi do të plotësohet kur të rishikohet kostoja e të gjithë strategjisë kundër trafikimit.

²⁸ Shifra të dhëna nga ZKKAT.

²⁹ Informacion i mbledhur nga OJF-të (Të ndryshëm dhe të barabartë, Tjetër vizion, Vatra dhe Qendra Kombëtare Pritëse). Shihni, gjithashtu, *Profili i situatës së trafikimit të viktimave dhe përpjekjet për përfshirje sociale*, Programi i Kombeve të Bashkuara "Mbështetje për përfshirjen sociale në Shqipëri", përgatitur nga IOM, janar 2015. Moshja e tyre varion nga 5–25 vjeç, shumica e të cilave janë nën 18 vjeç.

³⁰ Mbledhja e të dhënave nga OJF-të Tjetër vizion, Të ndryshëm dhe të barabartë dhe Vatra, si edhe nga QKPVT-ja.

³¹ Shih *Profili i situatës së trafikimit të viktimave dhe përpjekjet për përfshirje sociale*, Programi i Kombeve të Bashkuara "Mbështetje për Përfshirjen Sociale në Shqipëri", përgatitur nga IOM, janar 2015.



në formë abuzimi fizik, psikologjik, emocional, pakujdesie prindërore dhe varfërie ekstreme³². Prandaj, riintegrimi i tyre në familje, komunitet dhe shoqëri është proces sfidues dhe kërkon ndërhyrje të kujdesshme dhe të synuar nga aktorët kundër trafikimit.

c) Fuqizimi ekonomik

23. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave VT dhe VMT është me rëndësi parësore. Është faktor thelbësor në përballimin e shkaqeve bazë, të mundshme, të trafikimit, varfërisë dhe mungesës së mjeteve ekonomike. Fuqizimi mund të përshkruhet si “një proces nëpërmjet të cilit një individ mund të zhvillojë aftësinë e tij për të qëndruar në mënyrë të pavarur, të marrë vendimet e tij dhe të ketë kontroll mbi jetën e tij/saj”³³. Banka Botërore e përkufizon fuqizimin ekonomik të grave si “bërja e tregjeve funksionale për gratë dhe fuqizimi i grave për të konkurruar në tregje” (Banka Botërore, 2007)³⁴.

24. OKB, në Shqipëri e sheh fuqizimin ekonomik të grave si një proces që ka dy dimensionë kryesore: burimet dhe mundësitë. “Këto variojnë nga asete të matshme si burimet financiare (të ardhura, kursime, kredi) dhe burime fizike (tokë, strehim, teknologji) në asete të pamatshme, si aftësi, ekspertizë teknike dhe pozitive sociale. Por edhe kur gratë kanë burime produktive, kjo nuk do të thotë që ato janë të fuqizuara ekonomikisht. Ato duhet, gjithashtu, të kenë mundësinë për t’i përdorur këto asete sipas mënyrës që ato zgjedhin. Mundësia i referohet fuqisë së gruas për të marrë dhe për të vepruar bazuar në vendime që do ta lejojnë të marrë rezultate të vlefshme nga veprimtaria ekonomike”³⁵. Me më shumë kontroll dhe akses në asete, një grua ka më shumë fuqi për të marrë vendime që do të ndikojnë pozitivisht në mirëqenien e saj. Njëkohësisht, më shumë mundësi për të bërë zgjedhje në lidhje me ekonominë do të bëjnë të mundur që ajo të akumulojë më shumë burime për të siguruar suksesin e saj të qëndrueshëm ekonomik³⁶.

³² Shih, gjithashtu, Vlerësimin e Nevojave: Trafikimi i qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor, IOM, 2014 f. 37-38. Të njëjtat përfundime janë paraqitur në *Profilin e situatës së trafikimit të viktimave dhe përjekjet për përfshirje sociale*, Programi i Kombeve të Bashkuara “Mbështetje për Përfshirjen Sociale në Shqipëri”, përgatitur nga IOM, janar 2015.

³³ Praktika të mira në BE për integrimin e VT, f. 13.

³⁴ Maria Elena Ruiz, Abril, “Politika ekonomike të duhura për gratë në Shqipëri - Policy Issues and options for Women’s Economic Empowerment” *A Policy Issues Paper*, UNWOMEN 2012

³⁵ Shih planin e veprimit të OKB-së për Fuqizimin Ekonomik të Gruas në Shqipëri, 2014–2016.

³⁶ *Ibid*.

25. Për të arritur fuqizimin e grave viktimave të trafikimit, duhet që të ekzistojnë kushtet që ato të bëhen ekonomikisht dhe psikologjikisht të pavarura. Kjo kërkon mundësi për punë, arsim dhe trajnim dhe mënyrën në të cilën ofruesit e shërbimeve punojnë me viktimat. Gratë dhe vajzat duhet të inkurajohen që të bëhen pjesëmarrëse aktive në procesin e integritit.

26. Gjithashtu, është thelbësore të theksohet që ndërhyrjet e fuqizimit nuk mund të trajtohen të izoluara. Ato duhet të shihen në lidhje me veprimet e përgjithshme dhe politikatat e ndërmarra për fuqizimin e grave në përgjithësi në Shqipëri, sepse fuqizimi i grave për të marrë pjesë në ekonominë e Shqipëri është një nga katër qëllimet e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës me Bazë Gjinore, 2011–2015.

Gëzimi i të drejtave të pronësisë

27. Pranohet që aksesin dhe pronësia e tokës apo çdo pasuri tjetër e paluajtshme është një nga faktorët e fuqizimit ekonomik të grave. Të drejtat e pronësisë u japin grave siguri, një bazë nga e cila të prodhojnë, investojnë dhe krijojnë biznesin e tyre dhe të përmirësojnë mirëqenien e tyre. Ndikimi i të drejtave pronësore të grave (ose deprivimi i tyre) shkon përtej dhënies së mundësive ekonomike dhe është element thelbësor për aspekte të tjera të fuqizimit dhe mirëqenies së grave³⁷. Studimet tregojnë që pengesa *de facto* e ulin jashtëzakonisht aksesin dhe pronësinë nga gratë mbi tokën dhe pasuri tjetër të paluajtshme si shtëpi, ose apartament në Shqipëri. Sipas ligjeve të ndryshme që rregullojnë të drejtat e pronësisë në Shqipëri, si burrat dhe gratë gëzojnë të drejta të barabarta *de jure* për të pasur tokë. Megjithatë, regjistrimi i pasurisë në emër të kryefamiliarit (mashkull) identifikohet si një nga shkaqet kryesore të pronësisë së ulët mbi tokën nga gratë në Shqipëri³⁸. Kjo sjell një sërë pasojash për gratë që mund të privohen nga pasuria e tyre gjatë martesës, për shembull, duke qenë se gratë nuk janë regjistruar si pronare të një pasurie, një burrë mund ta shesë dhe ta japë pronën e tij pa nënshkrimin dhe pëlqimin e gruas së tij.

³⁷ Maria Elena Ruiz, Abril, “Politika ekonomike të duhura për gratë në Shqipëri - Policy Issues and options for Women’s Economic Empowerment”, *A Policy Issues Paper*, UNWOMEN 2012

³⁸ *Ibid*, f. 8–9, duke i referuar Stanley dhe Di Martino, 2011. Shihni, gjithashtu, Mandro, Arta, UN Women Studim, “Të drejtat e pronësisë së grave: Analizë e standardeve ligjore dhe zbatimi në praktikë”.



Edhe kur gratë kanë pronësinë e ligjshme të një prone, ato janë nën presionin e familjes së tyre për të hequr dorë nga të drejtat e tyre në favor të vëllezërve të tyre dhe të afërmve në përpjekje për të ruajtur pronën brenda familjes³⁹.

Punësimi⁴⁰

28. Punësimi është ndoshta faktori më i rëndësishëm në procesin e riintegrit, që mundëson pavarësinë ekonomike të grave për të plotësuar nevojat e tyre në periudhën afatgjatë. OJF-të në Shqipëri japin këshilla dhe informacion fillestar për tregun e brendshëm të punës, ndihmojnë në gjetjen e punës, në hartimin e jetëshkrimit; ndërgjegjësimin e kompanive private për rekrutimin e VT/VMT-ve, negocimin e kushteve të punës me punëdhënës të mundshëm; dhe ndjekjen gjatë punës. Disa OJF, gjithashtu, këshillojnë gratë për legjislacionin e punës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në mjedisin e punës.

Programe ekzistuese të nxitjes së punësimit

29. Programet e mëposhtme të qeverisë⁴¹ përbëjnë masa pozitive për të mbushur boshllëkun ndërmjet individëve të përjashtuar nga shoqëria dhe grupit të marxhinalizuar, që përfshin gra dhe vajza që kanë vuajtur nga një përvojë trafikimi:

1. Mbështetje për gratë e papuna⁴²

Sipas këtij programi, punëdhënësit që ofrojnë punësim për punëkërkuet e marxhinalizuara për të paktën një vit marrin 100 për qind të pagës minimale për katër muaj dhe 70 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Në rastin e kontratave dyvjeçare, punëdhënësit marrin pagë minimale për gjashtë muaj dhe 85 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Po kështu, në rastin e kontratave trevjeçare, punëdhënësit marrin pagë minimale për gjashtë muaj dhe 100 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Grupet e

synuara që përbëjnë “gratë e marxhinalizuara” janë gratë e trafikuar, mbi 35 vjeç, gratë rome, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë e divorcuara.

2. Mbështetje për punëkërkuet e papuna në vështirësi⁴³. Sipas këtij programi, punëdhënësit që ofrojnë punësim për punëkërkuet, për të paktën, një vit marrin deri në 100 për qind të pagës minimale për katër muaj dhe rimburohen për 100 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Përfituesit janë persona të papunë afatgjatë, persona që marrin ndihmë sociale, persona që marrin pagesa papunësie, personat nga 15–25 vjeç, që hyjnë në tregun e punës për herë të parë, personat mbi 45 vjeç që nuk kanë arsim më shumë se arsimi i mesëm ose ekuivalent, persona me aftësi të kufizuara, popullata rome dhe migrantët e kthyer. Punëkërkuet e papuna që kundërshtojnë pjesëmarrjen në këtë program do të hiqen nga lista e punëkërkuetve të papunë dhe nuk do të marrin ndihmë financiare dhe as pagesë papunësie.

3. Trajnim në punë për punëkërkuet e papuna⁴⁴. Sipas këtij programi, punëdhënësve që ofrojnë trajnim në punë për punëkërkuet e papuna iu jepet mbështetje financiare në formën e kostove të trajnimit (deri në 70 për qind të kostos). Gjithashtu, punëkërkuet që marrin pjesë në trajnime marrin 50 për qind të pagës minimale gjatë kohëzgjatjes së trajnimit, që nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj. Gjatë periudhës së trajnimit, ndihma financiare dhe pagesa e papunësisë e personit të papunë ndërpritet, por ajo ka të drejtë t’i rikuperojë pas përfundimit të trajnimit, nëse nuk është e punësuar. Punëdhënësi, në përfundim të periudhës së trajnimit, duhet të punësojë jo më pak se 50 për qind të të trajnuarve, për një periudhë 6-mujore. Ky program nuk trajton grupe specifike të synuara.

4. Trajnimi i të rinjve që përfundojnë arsimin universitar⁴⁵. Në këtë rast, si punëmarrësit ashtu edhe punëkërkuet përfitojnë 100 për qind të pagesës së papunësisë për një afat 6-mujor.

³⁹ Maria Elena Ruiz, Abril, “Getting Economic Policies Right for Women in Albania: Policy Issues and options for Women’s Economic Empowerment” *A Policy Issues Paper, UNWOMEN 2012, p. 8-9. Shibni, gjithashtu, Mandro Art, UN Women Studim “Të drejtat e pronësisë së grave: Analizë e standardeve ligjore dhe zbatimi në praktikë”* thekson aspektet e gjendjes ligjore dhe faktike të të drejtave të pronësisë së grave në Shqipëri.

⁴⁰ Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësi, 2014–2020, si dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 818, datë 26.11.2014.

⁴¹ Shihni ligjin nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit” të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

⁴² VKM nr. 27, datë 11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, të ndryshuar.

⁴³ VKM nr. 48, datë 16.1.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuetve të papunë në vështirësi”, të ndryshuar.

⁴⁴ VKM nr. 47, datë 16.1.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar.

⁴⁵ VKM nr. 873, datë 27.12.2006, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuet e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”.



Kandidati më i përshtatshëm përzgjidhet nga punëdhënësi pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara për këtë pozicion. Punëkërkuës të papunë, që kundërshtojnë pjesëmarrjen në këtë program, do të hiqen nga lista e punëkërkuësve të papunë. Ky program nuk trajton grupe specifike të synuara.

5. Mbështetje për të papunët me paaftësi fizike⁴⁶. Po kështu, ky program ofron mbështetje me të ardhura për punëkërkuës të papunë që janë të paaftë fizikisht. Punëdhënësit që ofrojnë punësim për punëkërkuës të paaftë fizikisht për të paktën një vit marrin mbështetje financiare që mbulon deri në 100 për qind të pagës minimale për 6 muajt e parë dhe 50 për qind për 6 muajt e ardhshëm. Gjithashtu, punëdhënësit marrin 100 për qind të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe mbështetje për përshtatjen e vendit të punës sipas nevojave të punëmarrësit me paaftësi fizike. Pas një viti, kontrata mund të shtyhet nëse zyra e punësimit miraton financimin për vazhdimin e këtyre masave mbështetëse.

Viktimat e trafikimit përfitojnë përjashtim nga tarifatat e kursit të formimit profesional, me kushtin që të jenë regjistruar si të papuna⁴⁷.

Mbështetje për sipërmarrjet e vogla

30. Mundësia për kredi dhe burime të tjera financiare është thelbësore për sipërmarrjen dhe zhvillimin e biznesit. Financimi është thelbësor për fillimin e bizneseve nga gratë dhe për forcimin dhe konsolidimin e bizneseve ekzistuese. Gjithashtu, është një element i rëndësishëm në rritjen e biznesit në sektorin formal⁴⁸. Mikrokreditë janë pjesë thelbësore e krijimit të biznesit nga gratë. Fatkeqësisht, në këtë drejtim në Shqipëri ka një boshllëk të madh, sepse mikrokreditë përfaqësojnë vetëm mbi 2% të tregut financiar⁴⁹. Është e rëndësishme të analizohet nëse VT-të dhe VMT-të mund të plotësojnë kriteret e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për të përfutur dhe për të patur akses në kapitalin fillestar (shih Matricën).

31. Mbështetja për sipërmarrjet e vogla vazhdimisht ka qenë komponent i programeve të

IOM-it dhe mbështetjes së donatorëve për VT-të dhe VMT-të në Shqipëri. Këto programe luajnë një rol të rëndësishëm për riintegrimin e viktimave të trafikimit sepse atyre u ofrohen burime financiare dhe trajnim për aftësitë sipërmarrëse, që të vijojnë në rrugën drejt vetëpunësimit. Duke përmirësuar situatën financiare të VT/VMT-ve, krijohen, gjithashtu, mundësi punësimi për familjarët dhe komunitetet vendore.

32. Megjithatë, përpjekjet dhe programet për mbështetjen e suksesshme të sipërmarrjeve të vogla varen nga klima e biznesit dhe kuadri rregullator, si edhe nga aftësitë individuale sipërmarrëse të gruas apo vajzës. Shumica e financimeve vijnë kryesisht nga vende donatore, zakonisht vendet e destinacionit. Programet më të fundit të qeverisë synojnë në mbështetjen e grave sipërmarrëse me një Fond për Gratë dhe një Fond Fillestar⁵⁰. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, është akoma e paqartë nëse VT-të dhe VMT-të plotësojnë kriteret formale të parashikuara në legjislacionin për të përfutur nga këto Fonde. Kjo çështje kërkon një vlerësim e analizë të mëtejshme, si dhe rekomandime.

Bizneset sociale

33. Sipas Raportit Kombëtar, 2014⁵¹ për Zhvillimin e Biznesit Social në Shqipëri, për të ulur varfërinë dhe për të trajtuar pabarazitë e mëdha në shpërndarjen e burimeve, ngritja e bizneseve sociale mund të jetë një alternativë e rëndësishme. Këto biznese mund të fokusohen në mbledhjen, përpunimin dhe furnizimin e tregut për shitje të produkteve organike me cilësi të lartë. Këto veprimtari ekonomike mund të japin një zgjidhje për rezidentët e varfër të këtyre zonave, për t'iu dhënë atyre punësim të qëndrueshëm dhe për të rritur të ardhurat për familjet e tyre, duke i fuqizuar ato ekonomikisht. Gra dhe vajza viktime të trafikimit dhe familjet e tyre që zakonisht vijnë nga situata të rënda ekonomike mund të përfutojnë nga një zgjidhje e tillë.

34. Termi “biznes social” zakonisht i referohet një veprimtarie biznesi që trajton një problem social dhe mjedisor, ku të ardhurat nuk shpërndahen por riinvestohen për të përmirësuar performancën e biznesit social ose bizneseve të

⁴⁶ VKM nr. 248, datë 30.4.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”.

⁴⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave “për tarifatat e sistemit të formimit profesional”, 4 prill 2006.

⁴⁸ MZHETTS (ish-METE) e cituar në Studimin e UN Women, Statusi i grave në Shqipëri.

⁴⁹ METE, Strategjia e Investimeve dhe Zhvillimit të Biznesit.

⁵⁰ Për më shumë informacion vizitoni <http://www.aida.gov.al/>

⁵¹ Ardita Bonatti, et.al., *NBS - Nxirja e Biznesit Social, Ndërmarrja Sociale, Inovacioni Social dhe Sipërmarrja Sociale në Shqipëri: Raport Kombëtar*, 2014 EFESIIS



tjera sociale”⁵². Shqipëria nuk ka legjislacion specifik që rregullon bizneset sociale. Ligji për Organizatat Jofitimprurëse njih të drejtën e OJF-ve për të kryer veprimtari ekonomike që i shërbejnë misionit dhe qëllimeve të organizatës⁵³. Në vitin 2011 u krijua Agjencia për Nxitjen e Biznesit Social në Shqipëri. Kjo është agjenci shtetërore dhe misioni i saj është të ndihmojë në përmirësimin e politikave qeverisëse për mbrojtjen sociale, proceset e përgjegjshmërisë dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. “Nxitja e Biznesit Social” dhe “Nxitja e Grave në Biznes” janë përfshirë, gjithashtu, në Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2013–2020, si edhe në Planin e Veprimit për Sipërmarrjen e Grave 2014–2020.

35. Sipas informacionit nga D&E; Vatra dhe Tjetër Vizion, disa gra VT/VMT kanë ndjekur tashmë alternativën e krijimit të bizneseve sociale. Edhe pse ka raste të sipërmarrëseve të suksesshme, është ende shumë shpejt për të vlerësuar suksesin dhe qëndrueshmërinë e këtyre përpjekjeve dhe për të dalë në përfundimin nëse rruga e biznesit social është zgjidhje më e qëndrueshme sesa sipërmarrjet e biznesit. Nga këndvështrimi i politikave fiskale, e vetmja taksë që nuk zbatohet ndaj bizneseve sociale është tatimi mbi të ardhurat, sepse ligjërish, në Shqipëri, biznese sociale si subjekte janë OJF-të që kryejnë një veprimtari ekonomike.

36. Gjatë fazës së konsultimit për hartimin e këtij plani veprimi, përfaqësues të bizneseve sociale dhe të NBS theksuan si një çështje problematike, konkurrencën e pandershme mes bizneseve. Ndihma e shtetit në këtë kontekst shihet si thelbësore për mbijetesën në ekonominë shqiptare të bizneseve sociale. Shteti, në përmbushje të rolit të tij për trajtimin e problemeve sociale dhe përmirësimin e përfshirjes sociale, duhet të krijojë mekanizma në mënyrë që bizneset sociale të përfitojnë, për shembull, një përqindje të vogël të kontratave të punëve publike. Kjo, sipas përfaqësuesve të bizneseve sociale, do të lehtësonte përgjegjësinë e shtetit për krijimin e vendeve të punës për individë nga grupe të marxhinalizuara, përfshirë VT/VMT-të.

37. Një analizë e thellë e politikave dhe

ndërhyrjeve të qeverisë për biznesin social është një fushë që shkon përtej qëllimit të këtij plan veprimi. Megjithatë, strukturat antitrafikim, si edhe struktura të tjera të rëndësishme të qeverisë me detyrë riintegrimin socio-ekonomik të VT/VMT-ve do të ndjekin nga afër çdo zhvillim që do të ketë ndikim mbi procesin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe veprimtaritë e gjenerimit të të ardhurave.

d) Strehimi

38. Sigurimi i strehimit të sigurt dhe të qëndrueshëm mbetet një nga aspektet më të vështira të integritimit, sidomos për ato gra dhe vajza që pas një përvoje trafikimi zgjedhin që të mos kthehen në shtëpi. OJF-të ndihmojnë gratë dhe vajzat që të marrin me qira një apartament të vogël në komunitetin ku dëshirojnë të vendosen, megjithatë, raportohet që gratë shpesh nuk janë në gjendje të lidhin kontrata qiraje me pronarët. OJF-të dhe donatorët paguajnë qiranë, zakonisht për një periudhë gjashtëmujore, ose deri kur gruaja gjen punësim afatgjatë. Në parim, gratë dhe vajzat VT dhe VMT duhet të kenë akses në programe të strehimit social në Shqipëri nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin shqiptar (shih më poshtë).

Programet sociale të strehimit në Shqipëri

39. Sipas nenit 2/3 të ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, këto programe zbatohen për strehimin e familjeve dhe individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Ligji parashikon tre programe të strehimit social: banesa sociale me qira, banesa me qira të ulët, dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë. Gjithashtu, qeveria ka përcaktuar parashikimin për subvencione për qiratë sociale, kredi të subvencionuara, grante të vogla dhe grante të menjëhershme që synojnë grupe specifike⁵⁴. Përfituesit e programeve sociale të strehimit duhet të plotësojnë një nga kushtet e strehimit: kanë mbushur moshën 18 vjeç; nuk kanë në pronësi një banesë; zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara të strehimit; ose kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore (neni 4). Përzgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e strehimit, familjare (familje njëprindërore, familjet me më shumë se katër fëmijë, të moshuarit,

⁵² Neni 3, ligji 10376/2011 për krijimin e NBS-së.

⁵³ Shih ligjin 8788/2001, neni 2/4; ndryshuar me ligjin 92/2013, neni 2/4/4/1 që qartëson kushtet sipas të cilave OJF-të mund të kryejnë veprimtari ekonomike.

⁵⁴ Shih UNDP, *Strehimi Social në Shqipëri: Analizë e situatës*, tetor 2014, përgatitur nga Marsela Dauti.



çiftet e reja), sociale (personat me aftësi të kufizuara, personat me statusin e jetimit, emigranti i rikthyer, punëtor emigrant, familjet e policëve të rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje. Viktimat e trafikimit nuk përmenden në mënyrë specifike në ligj, megjithatë ato mund të mbulohen nën kategorinë e familjeve me një prind ose viktimave të dhunës në familje.

40. Sigurimi i strehimit social është përgjegjësi e përbashkët e qeverisjes qendrore dhe qeverisjeve vendore⁵⁵. Qeverisja qendrore është përgjegjëse për sa më poshtë: Qeverisja qendrore është përgjegjëse për sa më poshtë: harton strategjinë 10-vjeçare të strehimit, në bazë të programeve 10-vjeçare të njësive të qeverisjes vendore për strehimin; planifikon Buxhetin e Shtetit për mbështetjen e realizimit të programeve vjetore të strehimit; përcakton rregullat e përgjithshme të zbatimit të programeve të banesave me kosto të ulët; informohet për administrimin e kërkesave për strehim nga njësitë e qeverisjes vendore; krijon bankën e të dhënave në nivel kombëtar për: i) nevojat për strehim me programe sociale strehimi; ii) inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike; iii) kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira; iv) numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit; v) sipërfaqen e nevojshme të truallit, që duhet pajisur me infrastrukturë për ndërtim banesash; vi) sipërfaqet e trojeve të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash; përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila miratohet çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave; përcakton çdo vit kriteret për investime ose blerje banesash nga tregu, në kuadër të banesave me kosto të ulët, që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera financimi; mbikëqyr realizimin e investimeve në programet sociale të strehimit me financime ose bashkëfinancime me Buxhetin e Shtetit. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për sa më poshtë: identifikojnë nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të këtij ligji për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre; hartojnë programe

10-vjeçare për strehimin dhe projekte trevjeçare, bazuar në burimet financiare që zotërojnë; sigurojnë sheshet e ndërtimit dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në bazë të këtij ligji; paraqesin kërkesat pranë ministrit që mbulon fushën e strehimit, për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji në bazë të informacionit, që dërgohet brenda muajit korrik të çdo viti, ku përcaktohen: i) numri i familjeve të regjistruara për t'u trajtuar me programet sociale të strehimit; ii) numri i familjeve, që janë trajtuar brenda një viti; iii) të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore, që do të përdoren për programet sociale të strehimit në vitin pasardhës dhe sasia e fondeve që kërkohen nga Buxheti i Shtetit, në bazë të programit 10-vjeçar të strehimit; iv) sipërfaqet e trojeve, të miratuara për programet sociale të strehimit; v) niveli i qirasë së miratuar me vendim të këshillit të njësive të qeverisjes vendore; krijojnë dhe administrojnë, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, sipas këtij ligji; përcaktojnë kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri që mbulon fushën e strehimit, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji; sigurojnë ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira; njoftojnë çdo vit ministrin që mbulon fushën e strehimit, për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji; kryejnë të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

41. Administratorët socialë janë aktorët kyçë për zbatimin e programeve të strehimit social. Ata i shërbejnë Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe verifikojnë situatën financiare të aplikantëve. Më pas, aplikantët informohen për rezultatet. Ata kanë të drejtë të ankohen për vendimin brenda 10 ditëve dhe të kërkojnë një vlerësim të dytë.

42. Nisur nga sa u tha më sipër, është përsëri e paqartë sesi gratë dhe vajzat VT/VMT përfitojnë praktikisht nga programet e strehimit social. Nga vlerësimet e OJF-ve vërehet se vetëm një numër shumë i ulët i grave ka aplikuar (vetëm një rast aplikimi është referuar nga OJF-të), ose lënë të kuptohet se mundësitë reale që një grua të përzgjidhet me anë të sistemit të pikëzimit janë pothuajse zero.

⁵⁵ Sipas ligjit 8652, 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", sigurimi i strehimit është një detyrë e autoriteteve vendore. Në mënyrë specifike, neni 72 përcakton që njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat do të jenë plotësisht përgjegjëse për të kryer funksionet e tyre...në planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimit [mes të tjerash]."



e) Arsimimi

43. Legjislacioni shqiptar njeh të drejtën e arsimit bazë. Individu ka të drejtë të regjistrohet në sistemin e arsimit bazë me kohë të plotë deri kur arrin moshën 17 vjeç. Nëse një individ ka mbushur moshën 17 vjeç, ai/ajo lejohet që të përfundojë vitin shkollor përkatës. Nëse një person është 16 vjeç dhe nuk ka përfunduar akoma arsimin bazë, ai/ajo ka të drejtë të regjistrohet në shkollë në programin me kohë të pjesshme të arsimit bazë. Me ligj, një person mund të ndjekë arsimin e mesëm deri në moshën 21–22 vjeç. Nëse një person është 22 vjeç dhe dëshiron të mbarojë arsimin e mesëm të lartë, ai/ajo ka të drejtë të regjistrohet në shkollat e arsimit të mesëm të lartë me kohë të pjesshme.

44. Në praktikë, regjistrimi në shkollë i VT/VMT-ve lehtësohet nga D&E, Tjetër Vizion dhe Vatra. Këto OJF kryejnë vlerësimin paraprak të nivelit arsimor të grave dhe vajzave VT/VMT dhe identifikojnë nevojat e tyre për arsim. Më pas, ato përipiqen të zgjidhin çështje të regjistrimit në shkollë direkt me Zyrën Arsimore, ose me shkollën. Vetëm raste të vështira i referohen AP-së. OJF-të raportojnë që nuk hasin vështirësi të mëdha në regjistrimin e grave ose vajzave në shkollë dhe bashkëpunimi i tyre me Drejtoritë Arsimore Rajonale është i mirë. Megjithatë ka raste kur viktimat e trafikimit (vajzat adoleshente) përballen me vështirësi⁵⁶ për regjistrimin në të njëjtin vit shkollor pas një përvoje relativisht të shkurtër të trafikimit. QKPVT ka edukatorët e saj dhe arsimi bazë ofrohet në qendër.

45. Masat e mëposhtme duhet të merren në fushën e arsimit të grave dhe vajzave VT dhe VMT përkatësisht:

a) Rishikimi i legjislacionit për të siguruar futjen përsëri në sistemin arsimor

Përfundimi i arsimit është kusht paraprak për gjetjen e punësimit. Viktimat e trafikimit që nuk kanë përfunduar arsimin kanë më pak mundësi për të gjetur punë. Ndihma për viktimat e trafikimit që të përfundojnë arsimin e tyre të ndërprerë duhet të konsiderohet përparësi⁵⁷ sa herë që është e mundur. Në fakt, OJF-të raportojnë që VT/VMT-

të përballen me vështirësi në gjetjen e punësimit sepse niveli i tyre arsimor është më i ulët, sesa niveli i kërkuar nga punëdhënësi të ndryshëm për vende pune të caktuara.

b) Udhëheqje

Udhëheqja akademike është, veçanërisht, e dobishme dhe shpesh thelbësore për riintegrimin e efektshëm të vajzave të trafikuar. Shpesh ato vuajnë nga boshllëqet prej një kohe të gjatë në arsimimin e tyre për shkak se kanë qenë të trafikuar. Kjo udhëheqje i ndihmon që të rifitojnë vitet e humbura të shkollës. Kjo, gjithashtu, duhet të konsiderohet për të lehtësuar rifutjen e efektshme në sistemin arsimor⁵⁸.

c) Mbështetje me orë shkrimi dhe këndimi

Është shqetësues fakti se strehëzat dhe QKPVT,⁵⁹ ende raportojnë raste të grave ose vajzave analfabete. Prandaj organizimi i orëve të shkrimit dhe këndimit dhe matematikës së thjeshtë është një detyrim me rëndësi primare.

d) Mbështetje për arsimin universitar

Të dhëna nga OJF-të tregojnë që disa VT/VMT duhet të kryejnë shkollimin universitar. Nëse një grua/vajzë është në proces të vazhdimin të ciklit universitar, viktimat që dëshirojnë të përfundojnë arsimin universitar duhet të vlerësohen nga organizata të ofrimit të shërbimit për të përcaktuar nëse është e mundur sipas planit të tyre të riintegrit⁶⁰.

f) Shërbime të kujdesit social

46. Në Shqipëri, mbrojtja sociale mbulon pagesat e ndihmës sociale (ndihmë ekonomike dhe ndihmë paaftësie); shërbimet e kujdesit social (ato që ekzistojnë dhe shërbimet e mundshme).⁶¹ Aktualisht, shërbimet e kujdesit social të financuara publikisht (përveç shërbimeve institucionale të kufizuara) janë shumë të kufizuara. Shumica e shërbimeve të kujdesit social ofrohen nga organizata të shoqërisë civile të financuara vullnetarisht ose nga partnerë të zhvillimit. Shërbimet më së shumti gjenden në zona më të mëdha urbane (90% janë në zona urbane) dhe 75% janë në zonën perëndimore dhe qendrore të

⁵⁸ Ibid.

⁵⁹ Edukatorë të specializuar për shembull në Qendrën Kombëtare të Pritjes (Streha e qeverisë për VI) zhvillojnë orë shkrimi dhe këndimi.

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Shihni Ligjin për ndihmën ekonomike dhe mbrojtjen sociale.

⁵⁶ Nuk duhet të ndodhte kështu sepse përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë anëtarë të AP-së dhe TT-së të Komiteteve Rajonale Antitrafikimit.

⁵⁷ *Manuali i IOM -së për Ndihmën e Drejtpërdrejtë për Viktimat e Trafikimit*, Arsimimi f. 96-97



vendit⁶². Shërbime të kujdesit social janë një pjesë shumë e vogël (më pak se 5%) e shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë për mbrojtjen sociale⁶³.

47. Megjithatë, në lidhje me VT-të dhe VMT-të, qeveria ka caktuar financim për OJF të specializuara (D&E, Tjetër vizion dhe Vatra) dhe ka krijuar një Qendër Kombëtare Pritjeje për VT/VMT në Tiranë. Këto strehëza janë të specializuara në trajtimin dhe përmirësimin e realizimit të të drejtave të VT/VMT-ve dhe kanë punuar me çështje të riintegritit për më shumë se një dekadë.

48. Paralelisht me hartimin e këtij plani veprimi, MMSR dhe UNICEF janë në proces të hartimit të një dokumenti politikash për paketën minimale të shërbimeve të kujdesit social për çdo person në nevojë për kujdes, pavarësisht vendbanimit. Parashikohet që paketa minimale e shërbimeve të kujdesit social të përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë përfshin vlerësimin e nevojave dhe njësitë e referimit në çdo komunitet dhe pjesa e dytë përfshin një kombinim të shërbimeve të ndryshme të kujdesit social, të ofruara nga subjekte private dhe publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Shërbimet për VT-të dhe VMT-të pritet që të përfshihen në variantin përfundimtar të këtij dokumenti politikash. Prandaj, aktorët e antitrafikim do të përfshihen në konsultimin dhe finalizimin e dokumentit në fjalë.

⁶² Studim i UNICEF për përcaktimin e shërbimeve të kujdesit social.

⁶³ Projektstrategji për Mbrojtjen Sociale, MMSR.



MATRICA
E PLANIT TË VEPRIMIT
PËR RIINTEGRIMIN SOCIO-EKONOMIK TË
GRAVE DHE VAJZAVE VT DHE VMT

PJESA I. MASA TË PËRGJITHSHME

| LEGJISLACIONI | | | | | | |
|---|---|---|---|---------------------------|-------------|---------|
| Rezultati | Objektivi 1: VT-ve dhe VMT-ve u ofrohet mbrojtje e veçantë nëpërmjet një programi asistence dhe integrimi socio-ekonomik të parashikuar me ligj | | | | | |
| Rezultati | Masa | Treguesi i ndikimit | Informacioni bazë | Institucionet përgjegjëse | Afati | Kostoja |
| VT-të dhe VMT-të kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë të parashikuar me ligj nëpërmjet një programi asistence dhe integrimi social. | <p>Krijimi i një grupi pune:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për të vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet e legjislacionit specifik për VT-të dhe VMT-të, - për të vlerësuar legjislacionin aktual të zbatueshëm për VT; dhe - për të krahasuar legjislacionin për TQNJ-në të vendeve të ndryshme; - për të vlerësuar <i>Dy alternativa</i>: a) Hartimi i legjislacionit specifik të ri. b) Rishikimi i legjislacionit që mbulon çdo aspekt të integrimit për të përfshirë dispozita specifike për VT-të dhe VMT-të. | Dispozitat ligjore krijojnë një program gjithëpërfshirës së riintegritit socio-ekonomik që përfshin ndihmën sociale, ligjore, shëndetësore, akomodimin e sigurt dhe zbatimin e programeve edukative dhe të punësimit. | <p>Legjislacioni shqiptar i zbatueshëm</p> <p>Traktatet Ndërkombëtare për TQNJ-në.</p> <p>Praktika Gjyqësore e GJEDNJ-së, ligji për TQNJ-në</p> <p>Raportet e GRETA⁶⁴</p> <p>Legjislacioni Kombëtar për TQNJ-në të vendeve të KiE-së</p> | ZKKAT MKR | 2016 – 2018 | |
| Rezultati | Objektivi 2: Rishikimi i procedurave standarde të punës për të qartësuar funksionet dhe përgjegjësitë e çdo sektori në fushën e riintegritit socio-ekonomik | | | | | |
| Rezultati | Masa | Treguesi i ndikimit | Informacioni bazë | Institucionet përgjegjëse | Afati | Kostoja |
| PSV të rishikuara mbulojnë të gjitha aspektet e riintegritit socio-ekonomik dhe miratohen nga KM-ja. | Rishikimi i PSV për të përfshirë të gjitha aspektet e riintegritit socio-ekonomik, si pjesë e rishikimit të përgjithshëm të PSV aktuale të parashikuar në Strategjinë kundër Trafikimit. | Të gjithë aktorët janë të qartë dhe zbatojnë funksionet e tyre në lidhje me riintegritin socio-ekonomik të VT-ve dhe VMT-ve në mënyrë të efektshme dhe në kohë. | Varianti i 2011-s i PSV | ZKKAT MKR AP | 2016 | |

⁶⁴ Bazuar në rishikim paraprak të raporteve të GRETA rezultojnë që disa nga vendet e Këshillit të Evropës kanë legjislacion specifik antitrafikimit: **Bosnja dhe Hercegovina** “Rregulla për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve të TQNJ që janë shtetas të Bosnjë Hercegovinës”; **Bullgaria** “Ligji për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”; **Kroacia** “Protokoll për Identifikimi, Asistenca dhe Mbrojtja e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore” dhe “Protokoll për integrimin/riintegrimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore”; **Qipro** “Ligji për luftën kundër trafikimit dhe shfrytëzimin e personave dhe mbrojtjen e viktimave”; **Gjeorgjia** “Ligji për Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”; **Itali** “Ligji nr. 228/2003 për “Masat kundër trafikimit të personave”, dhe një program afatgjatë i mbrojtjes dhe integrimit sipas nenit 18 të Dekretit Legjislativ të Aktit të Konsoliduar të Imigracionit nr. 24/2014 që transponon Direktivën e BE-së 2011/36; **Letonia** “Rregullore nr. 889 për “Procedurat me anë të të cilave viktimat e TQNJ marrin shërbime të rehabilitimit social dhe kriteret për të dalluar një person si viktimë të TQNJ”; **Moldavi** “Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”. http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/trafficking/Docs/Publications/Evaluations_en.asp.



| NGRITJA E KAPACITETEVE | | | | | | |
|---|--|--|---|---|-----------|---------|
| Objektivi 3: Rritja e njohurive dhe kapaciteteve të aktorëve në fusha të riintegritimit socio-ekonomik | | | | | | |
| Rezultati | Masa | Treguesi i ndikimit | Informacioni bazë | Institucionet përgjegjëse | Afati | Kostoja |
| <p>Njohuria e institucioneve kundër trafikimit dhe ofruesve të shërbimeve për riintegrimin socio-ekonomik është e konsoliduar dhe e shtrirë rregullisht.</p> <p>Rezultatet e studimeve dhe raporteve informojnë procesin e vendimmarrjes së institucioneve dhe shërbimeve kundër trafikimit për masat për riintegrimin.</p> | <p>Krijimi i një platforme/mekanizmi kërkimi <i>online</i> për të informuar të gjithë aktorët kundër trafikimit për praktikën e asistencës/integrimit. Platforma do të përmbajë një përmbledhje të raporteve/studimeve/vlerësimit/legjislacionit/praktikave të mira në lidhje me TQNJ-në.</p> <p>Organizimi i seanceve/tryezave të rumbullakëta të rregullta të ndarjes së informacionit për studime/raporte të kryera për aspekte të ndryshme të riintegritimit socio-ekonomik [AP fton në takimet e tij përfaqësues të AIDA-s, Agjencisë Shtetërore për Nxjitjen e Biznesit Sociale (NBS) dhe MZHE'TTS, ekspertët për strehimin, punësimin, formimin profesional etj. për të ndarë këndvështrimet/rezultatet e studimit.</p> | <p>Nr. i profesionistëve që hyjnë në platformën e kërkimit në internet.</p> <p>Nr. i dokumenteve/materialeve që ngarkohen rregullisht.</p> | <p>Lista e Burimeve të përfshira në bibliografi e planit aktual të veprimit/façet e internetit të IOM, Institutit NEXUS/publikimet e BE-së dhe OKB-së etj.</p> | <p>ZKKAT OKB IOM OSBE Delegacioni i KE-së ZKKAT, AP, MZHE'TTS, AIDA, NBS</p> <p>Organizata Ndërkombëtare: IOM, UN WOMEN, UNDP</p> | 2015–2017 | |
| <p>Të gjithë zyrtarët publik janë në dijeni të të drejtave të viktimave dhe janë përfshirë në përpjekje riintegrimi.</p> | <p>Zhvillimi i trajnimit/veprimtarive për ngritjen e kapaciteteve me zyrtarët e bashkive/administratorët social/punonjësi social të Shërbimit Social Shtetëror dhe punonjësit e Zyrave të Punësimin për integrimin socio-ekonomik.</p> <p>Organizimi në bashkëpunim me AIDA dhe NBS i trajnimit për ofruesit e shërbimeve për fuqizimin ekonomik.</p> | <p>Nr. i punonjësve publik të trajnuar</p> | <p>Vlerësim i nevojave për trajnim i kryer nga IOM</p> <p>Mësimet e nxjerrja nga Seancat e Trajnimit të zhvilluara nga IOM në prill 2015</p> | <p>ZKKAT MKR Bashkitë IOM</p> | 2016–2017 | |
| MBLEDHJA E TË DHËNAVE, MONITORIMI DHE VLERËSIMI | | | | | | |
| Objektivi 4: Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave, menaxhimi i informacionit dhe monitorimi sistematik dhe vlerësimi i riintegritimit socio-ekonomik për të vlerësuar, nëse, dhe si është arritur riintegrimi dhe si mund të punohet me efektivitet | | | | | | |
| Rezultati | Masa | Treguesi i ndikimit | Informacioni bazë | Institucionet përgjegjëse | Afati | Kostoja |
| <p>Miratimi i treguesve të riintegritimit socio-ekonomik.</p> | <p>Miratimi i një liste me treguesit e riintegritimit socio-ekonomik.</p> | <p>Të gjithë aktorët monitorojnë dhe vlerësojnë planet individuale të riintegritimit dhe shërbimet bazuar në një listë gjithëpërfshirëse të treguesve.</p> <p>Lista e treguesve përdoret për të kryer një studim bazë për riintegrimin socio-ekonomik të VT-ve dhe VMT-ve.</p> | <p><i>Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR)</i></p> <p><i>Standardet kombëtare të kujdesit social për personat e trafikuar ose personat në rrezikë trafikimi në qendrat rezidenciale.</i></p> | <p>ZKKAT MKR AP SHSSH KKSAT</p> | 2016 | |



| | | | | | | |
|---|--|---|--|---|-----------|--|
| | | | Surtees, R., <i>Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual</i> 2010, Instituti NEXUS, Uashington | | | |
| SIVET prodhon raporte për të gjitha fushat e integritit socio-ekonomik të VI-së | <p>Rishikimi i SIVET-it për të përfshirë treguesit e sipërpërmendur të riintegritit socio-ekonomik, përfshirë aspektet e punësimit, formimit profesional, akomodimit afatgjatë, kujdesit social siç përcaktohet në standardet kombëtare të kujdesit social për personat e trafikuar ose personat në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale.</p> <p>Hartimi i një manuali ose guide për mbledhjen sistematike dhe periodike të të dhënave nëpërmjet bankës së të dhënave SIVET.</p> <p>Trajnimi i pikave fokale të hedhjes së të dhënave për mbledhjen sistematike të të dhënave për përdorimin e bankës së të dhënave.</p> <p>Përditësimi i SIVET në mënyrë periodike dhe sistematike me të dhëna të reja.</p> | Nr. i raporteve të detajuara të prodhuara nga SIVET për çdo aspekt të riintegritit në kohë. | <p>Banka e të dhënave e SIVET</p> <p><i>Standardet kombëtare të kujdesit social</i> për personat e trafikuar ose personat në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale (Standarde kombëtare) (anekse të detajuara)</p> <p>Raporte/formularë monitorimi të mbledhur bazuar në <i>Standardet kombëtare të kujdesit social</i> për personat e trafikuar ose personat në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale dhe Modelet e Institutit NEXUS.</p> | ZKKAT Pika fokale për hedhjen e të dhënave në AP | 2016–2017 | |
| Finalizimi i informacionit bazë për riintegritin socio-ekonomik. | Kryerja e një studimi bazë cilësor dhe sasior bazuar në treguesit e riintegritit socio-ekonomik të specifikuar më sipër. | Informacioni bazë do të përcaktohet për të vlerësuar suksesin e ndërhyrjeve/masave. | Të dhënat paraprake janë në dispozicion në / nëpërmjet ZKKAT dhe OJF-së. | ZKKAT OJF (KKSAT) | 2016 | |



PJESA II. FUQIZIMI EKONOMIK TË DREJTAT E PRONËSISË, PUNËSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

| TË DREJTAT E PRONËSISË | | | | | | |
|---|---|--|---|---|-----------|---------|
| Objekti 1: Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit për të drejtat e VT-ve dhe VMT-ve për të pasur dhe gëzuar pronën | | | | | | |
| Rezultati | Masa | Treguesi i ndikimit | Informacioni bazë | Institucionet përgjegjëse | Afati | Kostoja |
| Informacion dhe shërbime në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pasurisë që u ofrohen VT-ve dhe VMT-ve. | <p>Realizimi i fushatave dhe strategjive të tjera të komunikimit për të shpërndarë informacion për të drejtat ligjore të grave për të pasur pronë dhe për të kuptuar më mirë rëndësinë e mbajtjes së titujve të përbashkët.</p> <p>Diskutimi me përfituesit dhe aktorët i rezultateve/rekomandimeve të Studimit “Të drejtat e pronësisë së grave: Një analizë e Standardeve Ligjore dhe Zbatimi në Praktikë: Rasti i Shqipërisë”.</p> <p>Dhënia e këshillave ligjore dhe shërbimeve të ndihmës juridike për të drejtat e pronës së VT-ve dhe VMT-ve.</p> | <p>Nr. i VT/ofruesve të shërbimeve të informuar për të drejtat e pronësisë dhe trashëgimisë.</p> <p>Nr. i VT që përdorin shërbimet ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për pronën</p> | <p>Legjislacioni për pronësinë</p> <p>Studim i UN Women</p> | <p>Autoriteti Përgjegjës</p> <p>ZKKAT</p> <p>Shërbimi i ndihmës juridike falas, OJF</p> | 2015–2017 | |
| PUNËSIMI/VETËPUNËSIMI | | | | | | |
| Objekti 1: Rritja e aksesit të VT-ve dhe VMT-ve në punësim dhe mbështetja e VT-ve dhe VMT-ve për punësim të qëndrueshëm dhe/ose veprimtari gjenerimi të ardhurash, nëpërmjet sipërmarrjeve të vogla | | | | | | |
| Rezultati | Veprimtaritë | Treguesi | Informacioni bazë | Institucionet përgjegjëse | Afati | Kostoja |
| Identifikohet lidhja e aftësive dhe formimit profesional të VT/VMT-ve me tregun e punës. | <p>Kryerja e një studimi cilësor dhe sasior (e përfshirë si pjesë në studimin bazë të përmendur më sipër) për të përcaktuar afërsinë e VT me tregun e punës. Studimi do të rezultojë në propozime për të identifikuar lidhjet me tregun e punës dhe mënyrën e përmirësimit të tyre.</p> | <p>Përcaktohet informacioni bazë për lidhjet e VT me tregun e punës.</p> | <p>Plane individuale të integritit. [Të dhëna në lidhje me kualifikimin dhe edukimin jepen nga N&B, Tjetër Vizion dhe Vatra].</p> <p>Prodhimi i Dokumentit të Politikave i kryer nga UNDP Shqipëri në bashkëpunim me MMSR për politikën e reja dhe inovative të tregut aktiv të punës. Pritet që të finalizohet në korrik 2015.</p> | <p>Agjencia Shtetërore për Nxitjen e Biznesit Social (NBS)</p> | 2016 | |
| Bizneset sociale janë proaktive në nxitjen e aksesit në punësim dhe caktimin në punë për VT-të dhe VMT-të. | <p>Bizneset sociale i dërgojnë informacion NBS-së dhe qarkullojnë informacion mes tyre në lidhje me vendet vakante, projektet dhe mundësitë për punë.</p> | <p>Nr. i vendeve vakante në dispozicion.</p> <p>Nr. i VT-ve dhe VMT-ve që gjejnë punësim në bizneset</p> | <p>Nuk ka informacion bazë.</p> <p>NBS ka krijuar një bankë të dhënash për bizneset sociale.</p> | <p>NBS</p> <p>Të Barabartë dhe të Ndryshëm</p> <p>Tjetër Vizion</p> <p>YAPS</p> | 2015-2017 | |



| | | | | | | |
|--|--|--|---|--|------------------|--|
| <p>VT/VMT-të kanë punësim të sigurt dhe afatgjatë dhe të ardhura të qëndrueshme.</p> | <p>Bizneset sociale nënshkruajnë një MM për të mbajtur vendet vakante ekskluzive për VT, VMT, dhe viktimat e dhunës në familje për dy javë.</p> <p>Ndihma për VT/VMT-të për t'u integruar në tregun e punës nëpërmjet secilës nga këto alternativa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - punësim në një biznes social ekzistues; - punësim në një biznes social të krijuar së fundmi nga VT/VMT-të që janë përfshirë në formim profesional me mbështetjen e fondeve fillestare; - vetëpunësimi i VT/VMT-ve me mbështetjen e fondeve fillestare. <p>Ndjekja dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së biznesit dhe performancës.</p> | <p>sociale.</p> <p>Nr. i VT-ve dhe VMT-ve që kanë të ardhura të qëndrueshme dhe mbi nivelin kombëtar minimal të të ardhurave.</p> | | <p>Biznese të tjera sociale</p> | | |
| <p>Forcohen bizneset sociale që punojnë me VT-të dhe VMT-të ose që krijohen prej tyre.</p> | <p>Analizimi dhe rishikimi i planeve të punësimit dhe formimit profesional të VT-ve dhe VMT-ve dhe familjeve të tyre në rastin e riintegritimit në familjet e tyre.</p> <p>Përfaqësuesit e Bizneseve Sociale mblidhen rregullisht për të ndarë përvojën për vlerësimin e tregut, sfidat me të cilat përballen në lidhje me individët e pambrojtur.</p> <p>Bizneset sociale nënshkruajnë një MM për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin duke ndarë ekspertizë d.m.th. oficerë/menaxherë financiarë mbështesin dhe drejtojnë njëri-tjetrin në mënyrë reciproke.</p> | <p>Nr. i planeve të rishikuara dhe të përmirësuara të punësimit dhe formimit profesional.</p> <p>Nr. i takimeve konsultative mes bizneseve sociale.</p> <p>Nr. i binjakëzimit të bizneseve sociale me njëra-tjetrën.</p> | <p>Nuk ka informacion bazë.</p> | <p>NBS “Të ndryshëm dhe të Barabartë” “Tjetër vizion” YAPS</p> | <p>2015–2017</p> | |
| <p>VT-të dhe VMT-të kanë akses dhe gjejnë punësim në vende pune të <u>sektorit publik</u>.</p> | <p>ZKKAT bashkëpunon me SHKP për të pasur akses të rregullt dhe të përditësuar në informacion për vende pune të</p> | <p>Nr. i vendeve të punës në sektorin publik ku kanë akses VT-të dhe VMT-të.</p> | <p>Banka e vendeve të punës nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP).</p> | <p>ZKKAT SHKP “Të ndryshëm dhe të barabartë”</p> | <p>2015–2017</p> | |



| | | | | | | |
|--|--|---|---|--|------------------|--|
| | <p>përshtatshme për VT-të dhe VMT-të në sektorin publik.</p> <p>ZKKAT nënshkruan një MM me ministrinë dhe institucionet për të ndarë informacion në lidhje me vendet vakante.</p> <p>Ofruesit e shërbimeve/ punonjësit social vlerësojnë kriteret e punësimit, si niveli i arsimimit të kërkuar për punësim në sektorin publik dhe vlerësimi i përmbushjes së këtyre kriterëve nga VT-të dhe VMT-të.</p> <p>Lidhja e aftësive dhe arsimimit të VT-ve dhe VMT-ve me vendet e punës në sektorin publik.</p> <p>Krijimi në bashkëpunim me Ministrinë e Teknologjisë dhe Administratës Publike i një programi praktik në sektorin publik që ka në qendër VT/VMT.</p> | | <p>Plane individuale të integritimit.</p> | <p>“Tjetër vizion” “Vatra”</p> | | |
